



Datë: 18.11.2025

Numër Protokolli: 7043/2025

A.nr.1639/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, në përbërje nga: Arben Mehmeti, kryetar, Eshref Shabani dhe Ardita Haxhnikaj Demi, anëtarë, me Avdyl Bekteshi, në cilësinë e procesmbajtësit, në procedurën sipas ankesës me numër A.nr.1639/2025, të datës 29.08.2025, të parashtruar nga ankuesja E.R.H nga Prishtina, kundër organit të punësimit: Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, në çështjen juridike “*Kontestim konkursi*”, duke vepruar në pajtim me 53 paragrafi 1, nenin 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 6, paragrafin 1, nën paragrafin 1.1, nenin 16, paragrafin 3 dhe nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 18.11.2025, mori këtë:

V E N D I M

I. Shfuqizohet Vendimi A.nr.1639/2025, i datës 29.10.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

II. Hedhet poshtë si e pasafatshme ankesa A.nr.1639/2025, e datës 29.08.2025, e parashtruar nga ankuesja E.R.H.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil, E.R.H (*në tekstin e mëtejme referuar: Ankuesja*), përmes emailit më datë 28.08.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës e cila është regjistruar më datë 29.08.2025, kundër konkursit me Nr. Reference: RN00017396 për grupin e përgjithshëm të mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Mbeturina i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (*në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli*) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë te Ministria e Mjedisit, planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (tutje referuar MMPHI), ndërsa kjo e fundit, më datë 24.09.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit), vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritore administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 5797/2025 të datës 29.08.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Njoftimin e datës 28.07.2025 për kandidatin fitues; Kopjen e ID-së së ankueses; Kërkesën për përgjigje në ankesë datë 08.09.2025; Përgjigjen në ankesë e datës 24.09.2025; Formularin e renditjes përfundimtare të kandidatëve i datës 28.07.2025; Listën e pyetjeve të intervistës me gojë datë 20.06.2025; Njoftimin e datës 11.06.2025 për kandidatët të cilët kanë kaluar testin me shkrim; Formularin për vlerësimin e esesë; Testin me shkrim të ankueses dhe kandidatit fitues; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë; Vendimin me numër protokolli 4286/25 të datës 29.05.2025 për themelimin e Komisionit të Pranimit; Vendimin me numër protokolli 4286-2/25 të datës 30.05.2025 për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit të datës 29.05.2025 për formimin e komisionit të pranimit; Listën e aplikantëve; Rr-njoftimin e datës 21.05.2025 për verifikim paraprak; Njoftimin e datës 20.05.2025 për verifikimin paraprak; Vendimin e datës 08.05.2025 për shtyrjen e afatit për përfundimin e verifikimit; Konkursin me Nr. Reference: RN00017396, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Mbeturina; Aplikacionin e datës 14.04.2025 të kandidatit fitues me dokumentacionin nga faqe 1-15; Aplikacionin e ankueses i datës 23.04.2025 me dokumentacionin nga faqe 1-220; Vendimin A.nr.1639/2025, të datës 29.10.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kërkesën për rishqyrtim të vendimit e datës 11.11.2025 nga E.H.

Kolegji i Këshillit pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka gjetur se ankesa e ankueses **është e pasafatshme, sepse:**

Nga administrimi i shkresave të lëndës, rezulton se MMPHI, më datë 24.03.2025, ka shpall konkursin me Nr. Reference: RN00017396, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Mbeturina, si kategori e specialistit, i hapur për aplikim nga data 25.03.2025 deri më datën 23.04.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në konkursin përkatës të punësimit kanë aplikuar gjithsej 47 kandidatë, ku prej tyre 19 kandidatë mesin e tyre edhe ankuesja janë përfshirë në fazën e verifikimit paraprak.

Divizioni për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore i MMPHI-së më datë 28.07.2025 ka shpallur listën përfundimtare të vlerësimit ku sipas saj rezulton se ankuesja ka marr gjithsej 81 pikë si e dyta, ndërsa sipas njoftimit për kandidatin fitues të datës 28.07.2025 ka rezultuar se si kandidat fitues me më së shumti pikë është E.H me gjithsej 93 pikë,

Ankuesja, më datë 28.08.2025, përmes emailit ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet se bazuar në përgatitjen profesionale dhe përvojën e punës duhet të shpallet kandidate fituese sepse, gjatë vlerësimit të testit me shkrim jam vlerësuar me më pak pikë, ndërsa tek intervista me gojë jam përgjigjur saktësisht në të gjitha pyetjet. Kërkon aprovimin e ankesës, anulimin e rezultateve të datës 28.07.2025 njoftimin për kandidatin fitues e pastaj të ma jap të drejtën mua për këtë pozitë, ose në rastin më të pafavorshëm çështja të kthehet në pikën zero.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.10.2025, ka nxjerr Vendim A.nr.1639/2025, me të cilin ka aprovuar si të bazuar ankesën e ankueses, duke anuluar shpalljen e konkursit me Nr. Reference: RN00017396, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Mbeturina i shpallur nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës.

Kandidati fitues në këtë procedurë të pranimi z. E. H, më datë 11.11.2025, përmes emailit ka kërkuar që të rishqyrtohet Vendimi A.nr.1639/2025, i datës 29.10.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me arsyetimin se njoftimi për kandidatin fitues është publikuar më datë 28.07.2025, ndërsa nga data 29.07.2025 ka rrjedhë afati për ankesë, kurse ankesa e datës 28.08.2025 e parashtruar nga ankuesja kundër këtij konkursi është në ditën e 31 nga dita kur ka rrjedh afati për kontestim të kësaj procedure. Kërkon që të rishqyrtohet vendimi dhe të hedhet poshtë se e pas afatshme ankesa e ankueses.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës së ankueses, konstaton se sipas dispozitave të nenit 81 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative lidhur me llogaritjen e afateve, është përcaktuar se: *“1. Përveç kur parashikohet ndryshe me ligj, afatet do të përcaktohen në ditë, muaj apo vite. Mbarimi i afatit mund të përcaktohet edhe me një datë të caktuar kalendarike. 2. Kur afati përcaktohet në ditë, në llogaritjen e tij përjashtohet dita kur ka ndodhur ngjarja nga e cila fillon të ecën afati...”*, si rrjedhojë meqë sipas provave të lëndës, Njoftimi i datës 28.07.2025 për kandidatin fitues sipas konkursit me Nr.Reference: RN00017396, për Grupin e Përgjithshëm të Mjedisit, pozita Zyrtar i Lartë për Mbeturina është publikuar më datë 28.07.2025 dhe po ashtu edhe pala ankuese me datë 28.07.2025 në orën 3:42 është njoftuar përmes emailit nga Zyra e Personelit e MMPHI, për rezultatin përfundimtar, Kolegji i Këshillit, duke marr parasysh këtë dispozitë ligjore, konstaton se afati për ankesë ndaj njoftimit të datës 28.07.2025, rrjedh nga dita e nesërme respektivisht nga data 29.07.2025.

Duke marr parasysh normat ligjore të cekura më lartë, dhe po ashtu referuar edhe nenit 17 të Rregullores (QRK) Nr. 15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil, ku përcaktohet: *“Kandidatët e pakënaqur me procesin e rekrutimit, pas shpalljes së rezultateve përfundimtare kanë të drejtë ankese në KPMSHCK në afat prej tridhjetë (30) ditëve”*, Kolegji i Këshillit, vë në dukje se ankuesja ankesën e saj kundër kësaj procedurë të pranimi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, e ka parashtruar përmes emailit më datë 28.08.2025 dhe e cila është regjistruar më datë 29.08.2025, e që nëse i referohemi afateve ligjore e njëjta është parashtruar në ditën e 31 nga dita kur ka rrjedh afati për kontestimin e Njoftimit të datës 28.07.2025 për kandidatin fitues, rrjedhimisht Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës është jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 17 të Rregullores (QRK) Nr.15/2023 për Procedurën e Pranimi në Shërbimin Civil dhe në kundërshtim me afatin e parashikuar me nenin 127 paragrafin 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili shprehimisht përcakton: *“Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve, nga data kur është njoftuar për aktin administrativ”*.

Përkitazi me këtë, Kolegji i Këshillit, duke marr për bazë që ankesa e ankueses e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është e pa pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafin 1 nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, atëherë sipas kërkesës së datës 11.11.2025 së kandidatit fitues, është rishqyrtuar Vendimi A.nr.1639/2025,

i datës 29.10.2025, i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, mbi bazën e kërkesës për rishqyrtim të kandidatit fitues, duke marr parasysh dispozitat e nenit 53 paragrafi 1 dhe nenit 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ekziston baza ligjore për shfuqizimin e Vendimit A.nr.1639/2025, të datës 29.10.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Ndryshimi i vendimmarrjes sipas këtij vendimi në raport me Vendimin A.nr.1639/2025, të datës 29.10.2025, të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është si rezultat i rrethanave të reja të elaboruara si më lartë, kështu që në kuptim të nenit 8 paragrafi 2 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, është përcaktuar: *2. Një veprim administrativ nuk mund të ndryshojë në mënyrë të pajustificuar nga një praktikë administrative e mëparshme e të njëjtit organ për raste të njëjta a të ngjashme*, andaj sipas Kolegjit të Këshillit, ndryshimi i vendosjes së ankesës së ankueses është bërë në mënyrë të justifikueshme sikurse është thënë në këtë vendim.

Në mbështetje të asaj që u konstatue si më lartë e në mbështetje të nenit 18 paragrafi 1 nën paragrafi 1.7 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda: A.nr.1639/2025, datë 18/11/2025

Avdyl BEKTESHI

Procesmbajtës

Arben MEHMETI

Kryetar i Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses E.R.H;
- Kandidatit Fitues z.E.H.
- Udhëheqësit të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MMPHI; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.